

Shtojca 4: Model statuti

Statuti i Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës - STIKK

Ky statut do të qeverisë shoqatën jofitimprurëse **STIKK**, të themeluar në pajtim me Ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, Nr. 03/L-134, të shpallur nga Presidenti i Republikës së Kosovës më 06.03.2009 me dekretin Nr. DL-002-2009 dhe do të Qeverisë me Ligjin Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1

Emri, forma dhe adresa

- 1.1. Organizata do të quhet: ***Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës.***
- 1.2. Ajo mund të njihet edhe si ***STIKK.***
- 1.3. Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 16 dhe 20 të Ligjit Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
- 1.4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë organizatë.
- 1.5. Çdo transaksion ndërmjet STIKK dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet STIKK dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohet, përveç, nëse organi drejtues vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për STIKK-un, dhe se STIKK nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
- 1.6. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me paragrafin 1.4 të këtij Statuti dhe nenin 35 të Ligjit për Lirim të Asociimit në OJQ Nr.06/L-043 , me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.
- 1.7. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në: ***Rr. Rexhep Mala 28 A, Prishtinë, Republika e Kosovës.*** STIKK mund të ndryshojë zyret e saja në çfarëdo lokacioni në Kosovë me vendimin e Bordit të Drejtorëve.

Neni 2

Themeluesit

2.1.Themelues të organizatës janë:

1. ***Comtrade Computers, rr: “Eqrem Qabej”, P.N, Prishtinë, Republika e Kosovës;***
2. ***Cactus, rr: “Kolonja Ramiz Sadiku”, P.N, Prishtinë, Republika e Kosovës;***

3. *IPKO Telecommunications L.L.C, rr; “Nënë Terezë”, ndërtesa e RTK-së, kati 5, Prishtinë, Republika e Kosovës;*
4. *Elting Electronics, rr. Gazmend Zajmi, nr.9, 10060, Prishtinë, Republika e Kosovës*
5. *Data Com, Dardania, Kroi i Bardhë, L-9, Prishtinë, Republika e Kosovës*
6. *Pronet, Veternik, Zona Industriale, Prishtinë, Republika e Kosovës*

2.2. Kuvendi i Anëtarëve vendos për përfaqësuesin e autorizuar të OJQ-së, i/e cili/a përfaqëson organizatën dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai ose ajo është përgjegjës për informimin e autoriteteve kompetente për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e deklaruara në rastin e regjistrimit të organizatës.

2.3. **Autorizimet e përfaqësuesit të autorizuar.** Autorizimet ligjore të përfaqësuesit të autorizuar janë :

- (1) të përfaqësojë organizatën;
- (2) të pranojë njoftime dhe hetime zyrtare;
- (3) të nënshkruaj raportet për dorëzim në organet përkatëse;
- (4) të mbajë përgjegjësi juridike para organeve të regjistrimit dhe organeve tjera shtetërore;

2.4. **Emërimi dhe shkarkimi i përfaqësuesit të autorizuar.** Përfaqësuesi i autorizuar i STIKK emërohet dhe shkarkohet nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve. Autorizimet e përfaqësuesit të autorizuar i ushtron Drejtori Ekzekutiv. Në rast të ndryshimit të përfaqësuesit të autorizuar, organi përkatës i regjistrimit do të njoftohet sipas ligjit.

Neni 3 Qëllimi

3.1. Si zë i përbashkët i industrisë së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, STIKK promovon interesat e përbashkëta dhe konvergjente të bizneseve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit si dhe të profesionistëve dhe individëve nga këto lëmi. STIKK ka dedikim të ndihmojë në rritjen afatgjate të bizneseve të industrisë së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në Kosovë. STIKK është e përkushtuar të përmirësojë mjedisin e biznesit për teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit dhe të bëjë promovimin e kontributit të industrisë së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në rritjen dhe progresin ekonomik në Kosovë. STIKK mëton të marrë pjesë në zhvillimin dhe implementimin e politikave në Kosovë duke ndihmuar qeverinë dhe institucionet e Kosovës të kuptojnë trendet teknologjike aktuale dhe ato të së ardhmes dhe se si teknologjia mund të kontribuojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në Kosovë.

3.2. **Fushëveprimi.** STIKK përfaqëson interesat e industrisë së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit të Kosovës, si dhe interesat e profesionistëve në këto lëmi.

3.3 **Aktivitetet kryesore.** Në arritjen e qëllimeve të mësipërme, STIKK do të ndërmarrë, vetëm ose në partneritet me palë të tjera, në mënyrë direkte ose indirekte, të gjitha aktivitetet që janë të ndërlidhura, në mënyrë direkte ose indirekte, me qëllimet e STIKK. Në veçanti, STIKK do të zhvillojë këto aktivitete:

3.3.1. Inicion hulumtime për gjetjen e zgjidhjeve të mundshme për çfarëdo problemi me interes për industrinë e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në kuptim të gjerë, dhe në veçanti në kuptimin shkencor, teknik, institucional apo të burimeve njerëzore.

3.3.2. Avokon për një ambient më të mirë të biznesit, për interesat e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, për rritjen dhe konkurrueshmërinë, në Kosovë dhe jashtë saj.

3.3.3. Promovon dhe mbështet edukimin për teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit.

3.3.4. Publikon, promovon dhe kontribuon në deklaratimet dhe opinionet për çështje të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit të lëshuara nga institucionet dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare.

3.3.5. Merr pjesë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në formulimin, adoptimin dhe implementimin e politikave publike, legjislationit dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me industrinë e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.

3.3.6. Punon dhe kontribuon në themelimin, zhvillimin dhe publikimin e standardeve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.

3.3.7. Përbush funksionin e përfaqësuesit dhe zëdhënësit të industrisë së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit të Kosovës përballë institucioneve dhe qeverisë, mediave, organizatave tjera dhe kudo ku kjo ka rëndësi.

3.3.8. Merr pjesë në punën e organizatave tjera, brenda dhe jashtë Kosovës, dhe mund të anëtarësohet në këto organizata.

3.4. Parimet. Në përbushjen e qëllimeve dhe implementimin e aktiviteteve, STIKK do të bazohet në parimet e paanshmërisë, kushteve të barabarta për të gjithë, konkurrueshmërisë dhe tregut të lirë, të aplikueshme në Kosovë dhe më gjerë.

Neni 4 Anëtarësimi

Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Për t'u anëtarësuar në organizatë, secili i interesuar duhet të pranojë Statutin dhe Misionin e organizatës dhe të angazhohet për përbushjen e qëllimeve të organizatës.

4.1. Kategoritë e anëtarësisë. STIKK ofron dy lloje të anëtarësimit:

4.1.1. Anëtarë të plotë

4.1.2. Anëtarë bashkëpunues

4.2. Anëtarët e Plotë

4.2.1. Çfarëdo organizate që në Kosovë ofron publikisht produkte ose shërbime nga teknologjia e informacionit dhe e komunikimit ose që përfaqëson interesat e segmenteve të ngushta të kësaj industrie në Kosovë i plotëson kushtet për të qenë Anëtar i Plotë.

4.2.2. Anëtarët e Plotë kanë të drejtë vote për të gjitha çështjet në shqyrtim nga shoqata apo ndonjë organ i themeluar nga shoqata në punën e të cilit Anëtarët e Plotë marrin pjesë. Çdo Anëtarë i Plotë ka një votë. Votat e Anëtarëve të Plotë kanë peshë të barabartë.

4.2.3. Anëtarë të plotë mund të jenë:

(1) **Kompanitë** dhe format e tjera të operatorëve ekonomikë në Kosovë që teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit e kanë veprimtari primare.

(2) **Shoqatat e industrisë.** STIKK mund të pranojë si Anëtarë organizata dhe asociacione që përfaqësojnë fusha të caktuara të industrisë së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në Kosovë.

4.3. Anëtarët Bashkëpunues

4.3.1. Çfarëdo organizate që nuk i plotëson kushtet për të qenë Anëtar i Plotë por që merret me aktivitete të ndërlidhura me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit ose që në Kosovë ofron shërbime për këtë industri, i plotëson kushtet për të qenë Anëtar bashkëpunues. Individët gjithashtu mund të anëtarësohen si Anëtarë Bashkëpunues.

4.3.2. Anëtarët Bashkëpunues mund të marrin pjesë në punën e shoqatës dhe të të gjitha trupave të shoqatës por nuk kanë të drejtë vote.

4.3.3. Anëtarë Bashkëpunues mund të jenë:

(1) **Individët** dhe profesionistët në fushat e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit që janë qytetar të Kosovës apo me banim të përhershëm në Kosovë.

(2) **Organizatat jo-qeveritare dhe kompanitë** që merren me fusha të caktuara të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, si aktivitet dytësor ose përcjellës ose që u japin shërbime kompanive të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në Kosovë.

(3) **Institucionet dhe organizatat edukative** që ofrojnë në Kosovë programe shkollimi dhe përgatitje profesionale në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit.

(4) **Anëtarët Patron.** Mund të jenë kompani ose individë, me rezidencë në Kosovë ose jashtë saj, e që dëshirojnë të asocohen dhe të kontribuojnë në STIKK në cilësi të donatorit.

4.4. Përfaqësimi në Kuvendin e përgjithshëm të anëtarëve

4.4.1. Çdo Anëtar përfaqësohet në STIKK nga një person, Përfaqësuesi i Anëtarit. Një Përfaqësues nuk mund të përfaqësojë në të njëjtën kohë më shumë se një Anëtar.

4.4.2. Përfaqësuesi i Anëtarit merr pjesë në punën e Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve të STIKK dhe mund të marrë pjesë në cilindo organ tjetër të STIKK dhe të votojë në emër të Anëtarit.

4.4.3. Përfaqësuesi i Anëtarit mund të përcaktojë persona të tjerë për të pranuar informacione nga STIKK dhe thirrjet për takime, por jo edhe të delegojë përgjegjësitë për të marrë pjesë në takime dhe për të votuar në emër të Anëtarit.

4.4.4. STIKK mban dhe azhurnon regjistrin e Përfaqësuesve të Anëtarëve. Anëtari mund ta emërojë apo ndryshojë Përfaqësuesin e vet në çdo kohë duke dhënë njoftim me shkrim. Ky njoftim me shkrim i jepet Kryetarit të bordit apo Drejtorit ekzekutiv në çfarëdo forme në të shkruar duke përfshirë këtu emailin.

4.4.5. Me përfundimin e anëtarësimit të Anëtarit për çfarëdo arsye, do të konsiderohet se Përfaqësuesi i Anëtarit ka dhënë dorëheqje nga të gjitha funksionet që mund t'i ketë pasur në cilindo organ të STIKK.

4.5. Anëtarët e rinj, Procedura e pranimit

4.5.1. **Aplikimi.** Kompanitë, organizatat ose individët që duan të bëhen Anëtarë të STIKK duhet të plotësojnë aplikacionin për anëtarësim dhe t'ia dorëzojnë stafit administrativ të shoqatës. Aplikimi duhet të bëhet përmes formularit i cili duhet të dorëzohet në zyrat e shoqatës, me postë, ose përmes çfarëdo mënyre tjetër të shkruar duke përfshirë këtu e-mailin.

4.5.2. **Anëtarësimi.** Aplikacionet për anëtarësim do të shqyrtohen sipas përmbajtjes dhe kategorisë nga Bordi i Drejtorëve dhe do të aprovohen me shumicë të votave sipas nenit 4.2. Vendimet mbi aplikacionet e shqyrtuara do të komunikohen tek aplikuesit, me c'rast aplikacionet e aprovuara do të regjistrohen si anëtarë të rinj në regjistrin e anëtarëve të Shoqates.

4.5.3. Refuzimi dhe ankesa. Çdo aplikues ka të drejtë të ankohet në Njoftimit për mosregjistrim tek Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve. Ankesa i drejtohet Kuvendit përmes Kryetarit të Bordit.

4.6. Përfundimi i anëtarësimit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

4.6.1. Tërheqja. Cilido Anëtar që dëshiron të tërhiqet nga STIKK duhet të japë njoftim paraprak për këtë së paku 90 ditë përpara fillimit të vitit të ardhshëm financiar. Obligimet që burojnë nga kjo anëtarësi duke përfshirë obligimin për të paguar anëtarësinë, mbesin të pandryshuara deri në fund të vitit aktual financiar.

4.6.2. Përrjashtimi

(1) Cilido Anëtar mund të përjashtohet nga STIKK nëse nuk vepron në pajtim me Statutin ose me rregulloret e STIKK duke përfshirë këtu çfarëdo akti nën-statutor, ose që nuk i plotëson edhe më tutje kushtet për anëtarësi, duke përfshirë këtu por duke mos u kufizuar në ndryshimin e statusit si për shembull shitjen ose bashkimin e kompanisë. Përrjashtimi bëhet me vendim të Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve sipas rekomandimit të arsyetuar të Bordit të Drejtorëve.

(2) Mospagesa e anëtarësisë do të shërbejë si arsye e mjaftueshme për pezullimin e ofrimit të shërbimeve të Shoqatës deri në momentin e përmbushjes së obligimeve, nëse anëtarit i janë dhënë dy njoftime në çfarëdo forme me shkrim, duke përfshirë edhe emailin (me afat prej 90 ditësh pas njoftimeve). Pezullimi i shërbimeve mbetet në fuqi deri në pagesën e anëtarësimit, apo deri në Vendimin e Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve për përjashtimin e anëtarit, cilado që ndodh e para. Pezullimi i ofrimit të shërbimeve vendoset nga Bordi i Drejtorëve.

4.6.3. Kërkesat. Anëtari që përfundon së qeni Anëtar i STIKK për shkak të tërheqjes, përjashtimit ose çfarëdo arsyeje tjetër, nuk mund të ketë kërkesa apo fuqi vendimmarrëse ndaj punëve apo fondeve të STIKK. Ky Anëtar do të mbetet përgjegjës për shumën e anëtarësisë për vitin aktual fiskal.

4.6.4. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Çdo ankesë apo mosmarrëveshje që mund të paraqiten nga ose në lidhje me aplikacionin për anëtarësim, pezullimin e ofrimit të shërbimeve ose për çfarëdo çështje tjetër anëtarësie, do të zgjidhen nga një vetë anëtarët e Kuvendit të përgjithshëm apo një Komisioni për ankesa që mund të emërohet një herë në vit nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve. Vlerësimi i Komisionit i nënshtrohet aprovimit përfundimtar të Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 5

Kuvendi i Anëtarëve

5.1. Organi më i lartë drejtues. Kuvendi i Përgjithshëm i Anëtarëve është organi më i lartë drejtues i Organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të Organizatës.

5.2. Përgjegjësitë e Kuvendit. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës.

5.3. Funkcionet e Kuvendit. Kuvendi ka fuqinë e plotë të realizojë qëllimet e shtruar në Nenin 3.2. të Statutit dhe të aprovojë dokumentet strategjike të STIKK. Në veçanti, Kuvendi ka këto funksione:

5.3.1. Aprovon propozimet e Bordit të Drejtorëve për politikën dhe programin e STIKK;

5.3.2. Aprovon dhe amandamenton Statutin e STIKK dhe të gjitha aktet nën-statutore;

5.3.3. Aprovon planet e punës, buxhetin vjetor dhe raportet narrative dhe financiare;

5.3.4. Përcakton lartësinë e anëtarësimit;

5.3.5. Emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordit të Drejtorëve, duke përfshirë këtu edhe Kryetarin dhe Nën-Kryetarin e Bordit të Drejtorëve, përfaqësuesin e autorizuar dhe Drejtorin Ekzekutiv të STIKK

5.3.6. Vendos mbi emërimin e auditorit;

5.3.7. Merr vendim mbi çregjistrimin e shoqatës.

5.4. Delegimi i funksioneve. Përveç funksioneve që sipas ligjit, në mënyrë ekskluzive i takojnë Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve, Kuvendi mund të delegojë cilindo funksion të tijin në një komision ose bord të Anëtarëve të shoqatës. Kuvendi i Përgjithshëm i Anëtarëve mund të revokojë ose modifikojë delegimin e funksioneve të tij sipas pikës më sipër.

Neni 6 Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm

6.1. Mbledhjet dhe Agjenda. Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve merr vendime në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

6.1.1. Kryetari i Bordit të Drejtorëve, ose në mungesën e tij/saj, Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve, e thërret mbledhjen e rregullt të Kuvendit së paku një herë në vit.

6.1.2. Kryetari i Bordit të Drejtorëve, ose në mungesën e tij/saj Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve, është i obliguar të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit me kërkesën me shkrim drejtuar Bordit të Drejtorëve nga ana e së paku 1/3 të anëtarëve të Kuvendit. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Anëtarëve mund të thirret edhe me Vendimin e Bordit të Drejtorëve.

6.1.3. Përveç për mbledhje për arsye të cekura në Nenin 6.2 dhe Nenin 6.3. mbledhjet thirren nga Kryetari, ose në mungesë të tij Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve, së paku 30 ditë përpara duke dërguar njoftim paraprak në çfarëdo forme me shkrim duke përfshirë këtu njoftimin përmes e-mailit.

6.1.4. Njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë agjendën e mbledhjes dhe duhet të identifikojë në detaje të mjaftueshme çështjet për të cilat do të votohet.

6.1.5. Një çështje mund të futet në agjendën e mbledhjes së Kuvendit me kërkesën e Përfaqësuesve të së paku 1/3-tës së votave të Anëtarëve.

6.1.6. Mbledhjet e Kuvendit do të mbahen në çfarëdo vendi që specifikohet në ftesën për mbledhje.

6.1.7. Procesverbalin e mbledhjes do të mbahet nga një anëtar i Bordit të Drejtorëve i cili caktohet nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve. Procesverbalin duhet të përmbajë të gjitha vendimet e marra nga Kuvendi dhe duhet t'u dërgohet të gjithë Anëtarëve më së voni 10 ditë pas përfundimit të mbledhjes. Procesverbalin e dërgon Kryetari, ose në mungesë të tij, Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve.

6.1.8. Vendimet e marra në mbledhjen e Kuvendit do të regjistrohen në dokumentacionin zyrtar të STIKK nga Drejtorit ekzekutiv i STIKK.

6.2. Mbledhjet me procedurë të shkurtuar mund të mbahen në raste të jashtëzakonshme, të vlerësuara si të tilla me vendimin e Bordit Drejtues. Në këto raste, Kryetari ose Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve, duhet t'u dërgojë çështjet për shqyrtim të gjithë Anëtarëve përmes postës ose çfarëdo mediumi të komunikimit duke përfshirë këtu e-mailin. Vendimi mbi çështjen do të konsiderohet i aprovuar nëse brenda 15 ditëve nga dërgimi i çështjes për shqyrtim, numri i komunikimeve të kthyera Kryetarit ose Nën-Kryetarit të Bordit të Drejtorëve nga Anëtarët është i mjaftueshëm për kuorum dhe sipas rregullave për votim.

6.3. Mbledhjet e jashtëzakonshme. Në rast se mbledhjet me procedurë të shkurtuar dështojnë në kuorum, atëherë Kryetari ose Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve do të thërrasin Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të anëtarëve, me njoftim paraprak prej 7 ditësh. Kushtet e kuorumit dhe rregullat e vendimmarrjes mbesin të njëjta si për mbledhjet e zakonshme. Përrjashtimisht, afati për mbledhjen e dytë, në rast dështimit të kuorumit është më se paku 7 ditë në vijim.

6.4. Kuorumi, Shumica

6.4.1. Kuorumi. Përveç nëse është e përcaktuar ndryshe në këtë Statut, Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve mund të marrë vendime vetëm nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e Anëtarëve të STIKK me të drejtë vote. Nëse ky kusht nuk është i plotësuar, atëherë Kryetari ose Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve e thërret një mbledhje tjetër me agjendë të njëjtë brenda më së largu 60 ditëve në vazhdim. Kjo mbledhje nuk mund të thirret pa kaluar së paku dy ditë pas mbledhjes së parë të dështuar. Kjo mbledhje e përsëritur do të konsiderohet se ka plotësuar kuorumin pa marrë parasysh numrin e Anëtarëve me të drejtë vote prezent në mbledhje dhe kjo duhet të sqarohet edhe në ftesën për këtë mbledhje.

6.4.2. Shumica. Përveç nëse nuk është e përcaktuar ndryshe në këtë Statut, të gjitha vendimet e Kuvendit do të merren me 2/3 e votave valide të Anëtarëve me të drejtë vote prezentë në mbledhje. Votat bllanko, votat invalide dhe abstenimet nuk do të numërohen.

6.4.3 Votimi elektronik. Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve ka të drejtë të merr vendime edhe përmes votimit elektronik. Çështja për votim i dërgohet anëtarëve përmes emailit së paku 7 dite kalendarike para dates se caktuar për votim, me udhëzime për regjistrim para dates se votimit. Votimi do të jete i hapur 24h brenda dites se caktuar. Për tu konsideruar vendim i suksesshem nevojitet kuorum qe nenkupton pjesemarrjen e shumices se anetareve me te drejte vote te regjistruar paraprakisht. Vendimet aprovohen me 2/3 e votave elektronike pas kuorumit. Ne te kunderten. Keto vendime elektronike do të dokumentohen me dëshmi të ftesave dhe votave të pranuar në formë elektronike. Ne mungese te kuorumit, mbetet ne diskrecion te Bordit te STIKK per te vendosur nese ceshtja e njejte i adresohet Kuvendit per votim elektronik apo jo.

6.5. Pjesëmarrja e mysafirëve. Kryetari, ose kur në mungesë të tij e thërret mbledhjen Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve, mund të thërrasë personalitete të shquara ose përfaqësues të institucioneve apo organizatave tjera që të marrin pjesë si mysafirë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Kuvendit ose në diskutimet për të cilat ata janë ftuar të marrin pjesë.

Neni 7

Organi udhëheqës i ndërmjetëm (Bordi)

Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, organi udhëheqës i ndërmjetëm Bordi i Drejtorëve duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

7.1. Përbërja:

7.1.1. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 9 Anëtarë të Plotë.

7.1.2. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve zgjidhen dhe shkarkohen nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve.

7.2. Kryesimi i Bordit të Drejtorëve

7.2.1. Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe Nën-Kryetari zgjidhen nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve, për të kryesuar mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.

7.2.2. Kryetari i Bordit të Drejtorëve, dhe në mungesë të tij Nën-Kryetari kanë këto përgjegjësi:

- (1) Është përgjegjës për përmbushjen e vendimeve të marra nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve dhe nga Bordi i Drejtorëve;
- (2) Përfaqëson STIKK në lidhje me çështjet e politikave dhe të programit të STIKK;
- (3) Koordinon me përgatitjen, i thërret dhe i udhëheq mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe mbledhjen e Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve.

7.3. Mandati.

7.3.1. Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve është 2 vite me mundësi rizgjedhjeje, me përjashtim të situatës nga neni 7.3.4.

7.3.2. Nëse një anëtar i Bordit të Drejtorëve pushon së qeni anëtar i bordit gjatë mandatit të tij/saj për çfarëdo arsye, atëherë personi zëvendësues që vazhdon mandatin e këtij anëtari do të jetë personi i rradhës i votuar më së shumti në Kuvendin e fundit zgjedhor. Në rast se dy apo më shumë kandidatë kanë numrin e njejtë të votave, atëherë përzgjedhja do të jetë me emër sipas alfabetit.

7.3.3. Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve mund të shkarkojë anëtarët e Bordit të Drejtorëve në çdo kohë.

7.3.4 Në rastin kur janë më shumë se pesë (5) vende të lira për tu zgjedhur në Bordin e Drejtorëve, pesë (5) kandidatët me më së shumti vota zgjedhen me mandat 2 vjeçar, ndërsa kandidatët tjerë me mandat 1 vjeçar.

7.4. Funkcionet e Bordit të Drejtorëve

7.4.1. STIKK qeveriset nga Bordi i Drejtorëve në pajtim me vendimet e Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve dhe me mandatin e Bordit të Drejtorëve në bazë të këtij Statuti.

7.4.2. Përveç funksioneve të përmendura tjetërkund në këtë Statut, Bordi i Drejtorëve ka këto funksione:

- (1) Formulon dhe propozon politika dhe programe për aprovim nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve;
- (2) Formulon dhe propozon planet e punës dhe planet vjetore për aprovim nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve;
- (3) Përcakton prioritetet dhe aprovon planet e aktiviteteve;
- (4) Emëron kryesuesit e grupeve të politikave, grupeve punuese dhe komisioneve të shoqatës në bazë të propozimeve që vijnë nga këto grupe;
- (5) I formon dhe koordinon punën e grupeve punuese dhe të komisioneve të STIKK;
- (6) Përgatitë buxhetin vjetor për aprovim nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve;

- (7) Përgatitë dhe propozon aktet nën-statutore të STIKK për aprovim nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve;
- (8) Shqyrton aplikacionet për anëtarësim;
- (9) Udhëheq procesin e rekrutimit dhe shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv dhe ia rekomandon Kuvendit të anëtarëve për miratim

7.5. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve

7.5.1. Bordi i Drejtorëve mban mbledhjet e veta të rregullta të paktën katër herë në vit, me thirrjen e Kryetarit ose, në mungesë të tij/saj, të Nën-Kryetarit të bordit.

7.5.2. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve thirren duke dërguar dy javë paraprakisht njoftimin me shkrim, duke përfshirë këtu e-mailin. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve janë të hapura dhe çdo anëtar i Kuvendit mund të marr pjesë në to në cilësi të vëzhguesit. Drejtori Ekzekutiv marr pjesë në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, por nuk ka të drejtë vote.

7.5.3. Njoftimi për mbledhjen e Bordit duhet të përmbajë agjendën e mbledhjes dhe duhet të identifikojë në detaje të mjaftueshme çështjet për të cilat do të kërkohet të votohet.

7.5.4. Mbledhjet e Bordit mund të mbahen edhe përmes video-konferencave, me telefon ose përmes medimeve tjera elektronike përfshirë këtu *'Instant messaging'* dhe të tjera që u mundësojnë Anëtarëve të dëgjojnë njëri tjetrin dhe të bisedojnë direkt me njëri tjetrin. Kushtet e kuorimit dhe rregullat e vendimmarrjes mbesin të njëjta si për mbledhjet e rregullota.

7.5.5. Mbledhjet e Bordit do të mbahen në çfarëdo vendi që specifikohet në ftesën për mbledhje.

7.5.6. Procesverbali i mbledhjes do të mbahet nga një anëtar i bordit i cili caktohet nga Kryetari i bordit. Procesverbali duhet të përmbajë të gjitha vendimet e marra nga bordi dhe duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të bordit më së voni 10 ditë pas ditës së mbledhjes. Procesverbalin e dërgon Kryetari, ose në mungesë të tij, Nën-Kryetari i Bordit të Drejtorëve.

7.5.7. Vendimet e marra në mbledhjen e Bordit do të regjistrohen në dokumentacionin zyrtar të STIKK nga Drejtori ekzekutiv i STIKK.

7.6. Kuorumi, Shumica

7.6.1. Kuorumi. Përveç nëse është e përcaktuar ndryshe në këtë Statut, Bordi i Drejtorëve mund të marrë vendime vetëm nëse më shumë se gjysma e anëtarëve të bordit me të drejtë vote marrin pjesë në mbledhje. Nëse ky kusht nuk është i plotësuar, atëherë Kryetari i bordit e thërret një mbledhje tjetër me agjendë të njëjtë brenda më së largu 30 ditëve në vazhdim. Kjo mbledhje nuk mund të thirret pa kaluar së paku dy ditë pas mbledhjes së parë të dështuar. Kjo mbledhje e përsëritur do të konsiderohet se ka plotësuar kuorumin pa marrë parasysh numrin e anëtarëve të bordit prezent dhe kjo duhet të sqarohet edhe në ftesën për këtë mbledhje.

7.6.2. Shumica. Përveç nëse nuk është e përcaktuar ndryshe në këtë Statut, të gjitha vendimet e Bordit të Drejtorëve do të merren me shumicën e thjeshtë të votave valide të anëtarëve prezent në mbledhje. Votat bllanko, votat invalide dhe abstenimet nuk do të numërohen.

7.7. Grupet punuese, Komisionet

7.7.1. Bordi i Drejtorëve mund të formojë, sipas nevojës, komisione, grupe punuese dhe grupe tjera për çështje me interes. Grupet e tilla mund të përmbajnë edhe përfaqësues dhe ekspertë të jashtëm. Në raste të jashtëzakonshme, grupet punuese mund të formohen edhe nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve.

7.7.2. Grupet punuese dhe komisionet do të qeverisen nga aktet nën-statutore të miratuara nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve. Bordi i Drejtorëve përcakton Udhëheqësin e grupit punues në bazë të propozimit nga grupi punues.

Neni 8 Zyrtarët dhe Nëpunësit

8.1. Në rast nevojë organizata punëson persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës.

8.1.1. STIKK do të punësojë një person që të kryejë funksionet e Drejtorit ekzekutiv si dhe persona tjerë, sipas nevojës, që të ndihmojnë në kryerjen e funksioneve të Drejtorit ekzekutiv.

8.1.2. Drejtori ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Kuvendi i Përgjithshëm i anëtarëve, sipas procedurës së rekrutimit dhe rekomandimeve të bëra nga Bordi i Drejtorëve. Drejtori ekzekutiv i raporton Bordit të Drejtorëve dhe Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve.

8.1.3. Drejtori ekzekutiv i STIKK menaxhon dhe kontrollon aktivitetet e STIKK në baza ditore. Në veçanti, Drejtori ekzekutiv:

- (1) Është përgjegjës për funksionimin e stafit të STIKK duke përfshirë çështjet e personelit;
- (2) Siguron në mënyrë strikte paanshmërinë dhe neutralitetin e stafit të STIKK;
- (3) Është përgjegjës për shërbimet që u jepen Anëtarëve;
- (4) Është përgjegjës për përmbushjen e politikave dhe të programit të STIKK ashtu si janë përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve dhe aprovuar nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve;
- (5) Është përgjegjës për koordinimin në mes të Bordit të Drejtorëve, Anëtarëve dhe grupeve punuese dhe komisioneve të STIKK;
- (6) Merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve dhe mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- (7) Është përgjegjës për implementimin e buxhetit të aprovuar;
- (8) Ushtron funksione tjera të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve në pajtim me Statutin.
- (9) Përfaqëson STIKK-un në raportet kontraktuese me palët e treta

8.2. Zyrtarët duhet të punësohen në përputhje me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës, të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit, si dhe obligimet dhe përshkrimin e punës dhe përgjegjësiive të Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për organizatë. Nënpunësit e STIKK punësohen dhe shkarkohen nga Bordi i Drejtorëve sipas procedurës së rekrutimit dhe rekomandimeve të zhvilluara nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 9 Shpërbërja e organizatës

9.1. Shpërbërja. STIKK mund të shpërbërëhet në mënyrë vullnetare me Vendimin e Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve, apo me vendim të plotfuqishëm të gjykatës apo organit kompetent shtetëror dhe në rast të insolvencës.

9.2. Shpërndarja e pasurisë. Në rast të shpërbërjes së shoqatës, Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve do të vendosë për likuidimin e aseteve të STIKK dhe destinimin e fondeve dhe pasurisë së STIKK në

përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Vendimi për shpërbërje vullnetare mund të merret, pas arritjes së kuorumit, vetëm me një shumicë prej 2/3 të Anëtarëve të plotë prezent. Njoftimi për këtë mbledhje duhet t'i dërgohet me shkrim secilit Anëtar së paku 60 ditë paraprakisht.

9.3. Hyrja në fuqi. Vendimi për shpërbërjen e shoqatës sipas paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

Neni 10 Ndryshimet e statutit

10.1. Ndryshimet. Ky Statut mund të ndryshohet vetëm me Vendimin e Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve. Ndryshimet dhe plotësimet e propozuara i dërgohen anëtarëve të Kuvendit së bashku me Njoftimit për mbledhjen e Kuvendit. Njoftimi për këtë mbledhje duhet t'i dërgohet me shkrim secilit anëtar së paku 30 ditë paraprakisht.

10.2. Data efektive. Vendimi për ndryshimet e Statutit sipas paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi me datën e miratimit nga Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve të STIKK. Vendimi i Kuvendit dhe Statuti i ri dorëzohet në organet kompetente në pajtim me ligjin në fuqi.

10.3. Aktet nën-statutore. Krahas Statutit dhe ndryshimeve të tij Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve, me propozim të Bordit të Drejtorëve, miraton edhe akte nën-statutore në pajtim me Statutin, për të siguruar funksionimin dhe administrimin e STIKK si dhe për të plotësuar Statutin.

10.4. Nënshkrimet. Ndryshimet e Statutit, Vendimi mbi ndryshimet dhe aktet nën-statutore mbajnë dy nënshkrime dhe ate nënshkrimin e Kryesuesit të Mbledhjes së Kuvendit të anëtarëve, në të cilin të njetjat janë miratuar dhe nënshkrimin e Kryetarit të Bordit apo përfaqësuesit të autorizuar të STIKK.

Neni 11 Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar


11.1. Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Bordi i Drejtorëve i dorëzon Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve për aprovim raportin vjetor dhe raportin e audituar financiar për vitin paraprak deri më 31 Mars, ndërsa buxheti për vitin e ardhshëm dorëzohet bashkë me planin e punës deri më 25 Dhjetor.

11.2. Auditori. Kuvendi i përgjithshëm i anëtarëve përcakton Auditorin që të përgatisë raportin vjetor të shoqatës për vitin financiar. Ky raport i dorëzohet Kuvendit të përgjithshëm të anëtarëve.

Ky statut është aprovuar në Prishtinë

Më 24.05.2021

Nga anëtarëte Kuvendit


Nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar